

## **Firdes Shuli**

### **Komisionere**

Diplomuar “Jurist” në vitin 1988 në Fakultetin e Shkencave Politike-Juridike, Universiteti i Tiranës. Në vitin 2009, znj. Shuli u diplomua edhe në degën Administrim Publik në Fakultetin e Shkencave Shoqërore në Universitetin “Eqrem Çabej” në Gjirokastrë. Karriera profesionale e znj. Shuli ka nisur që nga viti 1988, fillimisht si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjirokastrë dhe më pas si kryetare e kësaj Gjykate, për tre vjet. Znj. Shuli është licencuar nga ministri i Drejtësisë si notere dhe, në vitet 1996-2017, ka ushtruar detyrën e noteres në Dhomën e Noterisë Gjirokastrë. Nga viti 2000 deri në vitin 2004, ajo ka ushtruar edhe profesionin e pedagoges në lëndët “E drejtë biznesi” dhe “E drejtë kushtetuese” pranë Universitetit “Eqrem Çabej” në Gjirokastrë. Nga viti 2001 deri në vitin 2017, noterja Shuli ka qenë anëtare e Asamblesë së Përgjithshme të Dhomës Kombëtare të Noterëve në Republikën e Shqipërisë. Ndërsa nga viti 2015 deri në 2017 ajo ka qenë anëtare e Kryesisë së Asamblesë së Përgjithshme të Dhomës Kombëtare të Noterëve. Znj Shuli ka kryer disa trajnime, ndërsa ka marrë pjesë në konferenca e seminare brenda dhe jashtë vendit, të organizuara nga Dhoma Kombëtare e Noterisë. Komisionerja Shuli është njohëse e mirë e gjuhës angleze. Në qershor të 2017 znj. Shuli, me vendim të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, u zgjodh si Komisionere në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.